

-me të cilën ka kryer veprën penale “ vjedhje pylli” nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73 dhe neni 69 të KPRK-së si dhe neni 495, të KPPRK-së .

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj ti paguajë dëmin e shkaktuar në shumë prej 665.55euro (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë pik pesëdhjetë e pesë cent) €, nën kërcenim e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1409-6/17 me datë 03.08.2017 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale “ vjedhje pylli” nga neni 358 par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënie e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.1409-6/17 me datë 03.08.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: fletëparaqitja e rojës së pyllit të Drejtorisë së Pyllit në Ferizaj me nr. 387/2017 i datës 17.07.2017, procesverbali i komisioni të ekspertëve i datës se njëjtë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në diapozitiv të këtij aktgjykimi .

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj ti paguajë dëmin e shkaktuar në shumë prej 666.55euro (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e pesë e pesë cent) €, nën kërcenim e ekzekutimit me dhunë

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20(njëzet euro) në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konformë nenit 450 par2.6 të KPRK-së obligohet i akuzuari që në paushallin gjyqësor në m shumën prej 20 njëzet euro, të në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit me dhunë

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1946/17 datë 15.19.2017

Procesmbajtëse
Albulena Topalli

Gjyqtarja Individuale

Hakile Ilazi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOBËNDE
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Më
Dana

07.11.2017

P.nr.1946/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm,
Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtëse-praktikanten Albulena Topalli, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1409-6/17 me datë 03.08.2017, për shkak të veprës penale “vjedhje pylli” nga neni 358 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, P PP/II.nr.1409-6/17 me datë 03.08.2017 dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.15.09.2017 mori këtë :

AKT GJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1409-6/17 me datë 03.08.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] me vendbanim ne [REDACTED], Komuna [REDACTED], i lindur me datë [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse me datë 04.07.2017 rreth orës 20:40 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari, në rajonin ekonomiko-pyJOR Nerodime-Jezerc, në vendin e quajtur ‘Prroi i Fanës’ me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 1 copë trungje të llojit të ahut, me dimensione të gjata bonitetit III m, me diametër 50-60 cm, gjithsej në kubaturë prej 4.93 metra kub, të cilat i ka transportuar me traktor të llojit Rakovic, vlera e dëmit të shkaktuar është 665.55 euro,-